

PËRGJIGJE E GRUPIT TË MENAXHERËVE TË BANKËS

PËR

KËRKESËN PËR RISHIKIMIN NGA PANELI I INSPEKTIMIT TË PROJEKTIT TË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË DHE RISTRUKTURIMIT TË SEKTORIT TË  
ENERGJISË PËR SHQIPERINE ( kredi e IDA Nr. 3872-ALB)

Grupi i Menaxherëve ka analizuar kërkesën për Inspektim të: Projektit të Prodhimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë, për Shqipërinë (kredi e IDA Nr. 3872-ALB, kërkesë e marrë nga Paneli i Inspektimit në datë 30 Prill 2007 dhe e regjistruar në datë 2 Maj 2007 (RQ07/03). Grupi i Menaxherëve ka përgatitur përgjigjen në vijim.



## PËRMBAJTJA

Shkurtime dhe akronimet.....	iv
<b>I. HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>II. KËRKESA .....</b>	<b>1</b>
<b>III. TË DHËNAT KRYESORE PËR PROJEKTIN .....</b>	<b>2</b>
KONTEKSTI I VENDIT .....	2
PROJEKTI .....	3
VLERËSIMI EKONOMIK I PROJEKTIT DHE ANALIZA E ALTERNATIVAVE.....	7
STATUSI I PROJEKTIT .....	10
<b>IV. PROBLEME QË LIDHEN ME MASAT MBROJTËSE.....</b>	<b>10</b>
MANGËSITË E SUPOZUARA NË LIDHJE ME RESPEKTIMIN E POLITIKËS SË BANKËS PËR MASAT MBROJTËSE .....	13
ZGJEDHJA E ZONËS DHE LIDHJET ME INVESTIME TË TJERA.....	14
SAKTËSIA E PËRPUTHJES SË MASAVE MBROJTËSE TË PROJEKTIT....	16
<b>V. PËRGJIGJA E GRUPIT TË MENAXHERËVE .....</b>	<b>19</b>

### Harta

- Harta 1. Projekti i Prodhimi dhe Ristrukturimit të sektorit të Energjisë: Zona e projektit në Vlorë (IBRD Nr. 35504)

### Aneksset

- Aneksi 1. Ankesat dhe Përgjigjet  
Aneksi 2. Datat kryesore që lidhen me Masat Mbrojtëse  
Aneksi 3. Raporti për problemin e pasurive natyrore, Korrik 2006  
Aneksi 4. Drafti i gjetjeve të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus  
Aneksi 5. Përgjigja e Bankës Botërore për draftin e gjetjeve të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus  
Aneksi 6. Përgjigja e Qeverisë Shqiptare për draftin e Gjetjeve të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus

## SHKURTIMET DHE AKRONIMET

BP	Procedurat e Bankës	ISDS	Formular i të Dhënave të Integruara të Masave Mbrojtëse
CAPBV	Aleanca Civile për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës	KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
CAS	Strategjia e Asistencës për Vendin	KfW	Banka Gjermane e Zhvillimit
CCGT	Turbinë Gazi me Cikël të Kombinuar	kWh	Kilovat orë
CTARA	Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë	MVA <sub>r</sub>	Mega Volt Amper reaktiv
EA	Vlerësim Mjedisor	MW	Megavat
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	NO <sub>x</sub>	Okside Nitrogjen
ECA	Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore	NPV	Vlera Neto Prezente
ECSIE	Njësia e Sektorit të Infrastrukturës dhe Energjisë në Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore	NSSD	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Shoqëror dhe Ekonomik
EIB	Banka Evropiane e Investimeve	OMS	Deklarata e Manualit të Funkcionimit
EMP	Plani i Grupi i Menaxherëve Mjedisorë	OP	Politika e Funkcionimit
EPC	Prokurime dhe Ndërtime Inxhinierike	OPN	Shënim i Politikës së Funkcionimit
ERR	Normë Ekonomike e Kthimit	PAD	Dokument i Vlerësimit të Projektit
EU	Komuniteti Evropian	PCD	Dokument i Konceptidesë së Projektit
GoA	Qeveria e Shqipërisë	PID	Dokument Informacioni për Projektin
GPRS	Strategjia e Zhvillimit dhe Uljes së Varfërisë	QACU	Njësia e Sigurimit dhe Respektimit të Cilësisë
GWh	Gigavat në orë	SO <sub>x</sub>	Okside Sulfuri
HFO	Naftë e rëndë	TEP	Plan për Energjinë Elektrike termale
IDA	Shoqata Ndërkombëtare e Zhvillimit	TT	Grupi i Punës
IFI	Institucione Ndërkombëtare Financiare	TTL	Drejtuesi i Grupit të Punës
IMF	Fondi Ndërkombëtar Monetar	TWh	Teravat orë
IPN	Paneli i Inspektimit	UCTE	Unioni për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë
IPP	Projekti i Pavarur i Energjisë	UNEP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
		USTDA	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

### Monedha

(sipas kursit te datës 23 Maj 2007)

1 ALL.= USD 0.0102 / USD 1 = 97.27 ALL

1 EUR = USD 1.35 / USD 1 = 0.74

### Njësitë matëse

1 kWh = 1000 Watt-ore

1 MWh = 1000 kWh

1 GWh = 1,000,000 kWh

1 TWh = 1,000,000,000 kWh

## I. HYRJE

1. Në datën 2 Maj 2007, Paneli i Inspektimit regjistroi një Kërkesë për Inspektim RQ07/03 (në vazhdim do t'i referohemi si Kërkesa) në lidhje me Projektin për Prodhimin dhe Ristrukturimin e Sektorit të Energjisë (Kredi Nr. 3872-ALB) financuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim. (IDA).

2. Dokumenti përmban pjesët e mëposhtme: Pjesa II paraqet Kërkesën; Pjesa III përshkruan projektin dhe kontekstin e vendit; Pjesa IV diskuton problemet lidhur me masat mbrojtëse, dhe Pjesa V përmban përgjigjen e Grupit të Menaxherëve. Aneksi 1 paraqet Kërkesat e Ankuesit, së bashku me përgjigjet e hollësishme të Grupit të Menaxherëve, në formatin tabelë. Aneksi 2 përmban një përshkrim kronologjik të datave kryesore në lidhje me aspektet e masave mbrojtëse të projektit. Aneksi 3 është raporti i vizitës së konsulentit të nivelit të lartë ekspert për pasuritë kulturore në zonën e projektit në Korrik 2006. Aneksi 4 përfshin gjetjet draft të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus (shih paragrafin 62). Aneksat 5 dhe 6 përmbajnë përgjigjet e Bankës Botërore dhe të Qeverisë Shqiptare në lidhje me draftin e gjetjeve të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus. Këtu gjendet një hartë e zonës së projektit (IBRD Nr. 35504).

## II. KËRKESA

3 Kërkesa për inspektim është dorëzuar nga z. Lavdosh Ferruni, në emër të Aleancës Civile për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës dhe tetë persona banues në qytetin e Vlorës. (në vazhdim do t'i referohemi si Ankuesit”).

4 Bashkëngjitur Kërkesës është edhe faqja e parë e një letre dërguar në Qershor të vitit 2005 nga Aleanca Qytetare në vëmendje të Bankës Botërore. Ndonëse Kërkesa i referohet disa dokumenteve bashkëngjitur, të cilat do të dërgoheshin me postë normale ose elektronike, Grupi i Menaxherëve nuk ka marrë materiale të tjera në mbështetje të Kërkesës.

5 Kërkesa përfshin ankesat, që sipas përcaktimit të Panelit mund të përbëjnë shkelje prej Bankës së klauzolave të ndryshme të politikave dhe procedurave të saj, të cilat janë :

- OMS 2.20, Vlerësim Projekti, Janar 1984;
- OP/BP 4.01, Vlerësimi Mjedisor Janar 1999 (rishikuar në Gusht 2004);
- OP/BP 4.04, Habitatet Natyrore, Qershor 2001;
- OP/BP 4.12, Migracioni i Detyrueshëm, Dhjetor 2001;
- OP/BP 10.04, Vlerësimi Ekonomik i Investimeve, Shtator 1994;

- OPN 11.03, Grupi i Menaxherëve i Pasurive Kulturore në Projektet e financuara nga Banka, Shtator 1986; dhe
- OP/BP 13.05, Mbikëqyrja e Projektit, Korrik 2001.

### III. TË DHËNAT KRYESORE PËR PROJEKTIN

#### KONTEKSTI I VENDIT

6 Shqipëria ka vuajtur nga mungesa e energjisë elektrike duke nisur nga vera e vitit 2000. Kjo shpjegohet me kërkesën në rritje për energji elektrike dhe me kushtet hidrologjike të pafavorshme në një realitet shqiptar, ku sistemi i prodhimit të energjisë bazohet kryesisht në burimet ujore (95%). Shqipëria vazhdon të jetë një eksportues neto i energjisë që nga viti 1997 dhe vazhdon të eksportoje energji në sasi të konsiderueshme (nga 300 GWh në vitin 1998 në 2,200 GWh në vitin 2002). Kushtet hidrologjike të përmirësuara gjatë periudhës 2003–2005 sollën një nivel më të ulët të eksportit dhe të ndërprerjeve. Varësia e ekonomisë shqiptare nga sasia e reshjeve ka vazhduar të rritet në kushtet e mungesës së kapaciteteve të reja termale të prodhimit të energjisë. Në fund të vitit 2006 dhe në fillim të vitit 2007 vendi ka vuajtur nga ndërprerje të shumta të furnizimit me energji.

7 Kriza energjetike ka pasur shumë impakte negative tek të varfrit. Impakti direkt i ndërprerjeve i privon ata nga ndriçimi, ngrohja dhe gatimi, duke ndikuar negativisht në nivelin e jetesës dhe shëndetit, si edhe duke kufizuar mundësinë e të mësuarit. Së dyti, përdorimi i fondeve të buxhetit të shtetit për importin e energjisë nuk lejon përdorimin e tyre për uljen e varfërisë. Së treti, kjo krizë ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik, i cili njihet si instrumenti kryesor për uljen e varfërisë në vend.

8 Kriza ka ndikuar në performancën ekonomike në shumë mënyra. Rënia e prodhimit të energjisë nga hidrocentralet është shkaku kryesor i rënies së prodhimit kombëtar. Importi i energjisë sjell rritjen e deficitit tregtar të vendit. Ndërprerjet e energjisë çojnë në ndërprerje të prodhimit industrial, të cilat i detyrojnë ndërmarrjet industriale dhe tregtarët të instalojnë gjeneratorë të kushtueshëm. Një studim i sektorit të Energjisë<sup>1</sup> i përfunduar në Janar të vitit 2003 vlerësonte se këta gjeneratorë prodhojnë energji, e cila është e barabartë me 15% të sasisë që ata (ndërmarrjet industriale dhe

---

<sup>1</sup> DECON, EDF, LDK Consultants, Lahmeyer Int and GEI- ENERGY, “Studim i Sektorit të Energjisë në Shqipëri” Janar 2003. Studimi jep: (i) parashikimet e kërkesës për energji deri në vitin 2015; (ii) një program investimi për prodhimin e energjisë më pak të kushtueshme që mbulon të njëjtën periudhë kohe; (iii) një master plan të transmetimit të energjisë; (iv) një plan për zvogëlimin e humbjeve teknike dhe jo teknike të energjisë; (v) një plan për transmetimin e energjisë ; (vi) një master plan për shpërndarjen e energjisë; (vii) një vërtetim apo studim për sektorin e ngrohjes; (viii) një vlerësim i fisibilitetit teknik dhe ekonomik për importin e gazit natyror ; (ix) strategjia e benzinës; (x) një plan i përgjithshëm investimi dhe alternativat e financimit; (xi) reforma e tarifave të energjisë elektrike duke marrë në konsideratë parashikimet afatgjata të kostos marxhinale dhe performancës financiare; dhe (xii) rekomandimet për ristrukturimin e sektorit të energjisë.

tregtarët) marrin nga rrjeti. Mungesat e energjisë renditen gjithashtu nga biznesmenët ndër faktorët që zvogëlojnë ekspansionin e mallrave të tregtueshme.

9. Nevojat e Shqipërisë për energji elektrike janë plotësuar kryesisht vetëm nga hidrocentralet, furnizimi prej të cilëve është i paqëndrueshëm, sepse prodhimi i tyre varet nga reshjet. Kapaciteti *potencial* i përgjithshëm i hidrocentraleve në vend vlerësohet në nivelin e rreth 3,000 MW, me një potencial vjetor prodhimi prej rreth 10 TWh. Megjithatë kapaciteti aktual i instaluar është 1,450 MW dhe prodhimi mesatar në një vit normal hidrologjik është rreth 4,000 GWh, krahasuar me kërkesën e tanishme prej rreth 6,800 GWh. Kaskada e lumit Drin me një kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 1,350 MW (Fierze – 500 MW, Komani – 600 MW, dhe Vau i Dejës – 250 MW), sigurojnë rreth 90% të prodhimit të energjisë në vend. Pjesa e mbetur prej 100 MW e kapacitetit të hidrocentraleve realizohet nga hidrocentralet e ngritur mbi lumenj të tjerë. Problemet që burojnë nga varësia e madhe prej hidrocentraleve të ngritura vetëm mbi një lumë përkeqësohet edhe më shumë nga fakti që prodhimi i energjisë është përqendruar në veri të vendit, ndërkohë që qendrat me ngarkesë më të madhe gjenden në pjesën qendrore dhe jugore të vendit.

10. Sigurimi në të ardhmen i sasive të konsiderueshme të energjisë nga importi nuk është i sigurt. Kapaciteti i brendshëm i siguar nga termocentralet nevojitet për të zvogëluar varësinë nga importet dhe për të diversifikuar prodhimin e brendshëm. Një studim i financuar nga Banka lidhur me kërkesën dhe ofertën e energjisë në Evropën Juglindore (2002-2012)<sup>2</sup> arrin në përfundimin se një mungesë më e shpejtë në kohë e kapacitetit prodhues mund të shfaqet në rajon nëse vazhdojnë të mungojnë kapacitetet e reja prodhuese. Ndaj, çmimi i energjisë së importuar në vendet deficitare në rajon pritet të rritet në nivelet e kostos së plotë të energjisë nga njësitë e reja prodhuese, nëse nuk do të jetë më i lartë. Kapaciteti plotësues i prodhimit të brendshëm për Shqipërinë do të ulte ndjeshëm varësinë nga importet dhe në këtë mënyrë rriste mundësinë për të furnizuar në raste ndërprerjesh dhe rritje çmimesh. Mungesat kanë filluar të shfaqen në rajon dhe çmimi i energjisë së importuar është rritur ndjeshëm (çmimi mesatar i importit është rritur nga 4.4 Lek/kilovat orë në vitin 2004 në 9.1 Lek/ kilovat orë në vitin 2007). Shqipëria po përballet me shumë vështirësi në sigurimin e energjisë së mjaftueshme nga importi.

## PROJEKTI

11. E ndërjegjshme për masën e krizës energjetike dhe implikimet e saj serioze, Qeveria përgatiti në fund të vitit 2000 një Plan Veprimi për të trajtuar problemet kritike. Plani përfshinte masat për reduktimin e humbjeve të energjisë, përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave, uljen e kërkesës dhe rritjen e tarifave, si edhe masa të tjera me spektër të gjerë, të cilat do të përmirësonin në mënyrë urgjente performancën e sektorit. Qeveria aprovoi gjithashtu një Deklaratë të Politikës së Sektorit në Prill 2002, duke përcaktuar sektorët ku do të zbatoheshin reforma dhe një Strategji Kombëtare të Energjisë në Qershor 2003, duke identifikuar investimet prioritare, nevojat për financim dhe reformat

<sup>2</sup> “Studim i Kërkesës dhe Ofertës së Energjisë në Evropë,” Banka Botërore, ECSIE, 2003.

e nevojshme për sektorin e energjisë. Në përputhje me strategjinë e përfshirë në këto dokumente, Qeveria u përpoq të gjente fonde për njësi prodhuese, të cilat do të zgjidhnin problemin e mungesës së energjisë. Studime të ndryshme të realizuara nga Qeveria identifikuan qartë se shtimi i kapaciteteve të brendshme termale të prodhimit ishte i nevojshëm për të zvogëluar varësinë e madhe nga importet, diversifikuar prodhimin e brendshëm dhe reduktuar varësinë nga kushtet hidrologjike. Shtimi i kapaciteteve termale do të përmirësojë sigurimin e vazhdueshëm të energjisë elektrike dhe do të lehtësojë rilidhjen e Shqipërisë me rrjetin e Evropës Perëndimore.

12. Qeveria i kërkoi Bankës asistencë për koordinimin e financimeve për një termocentral elektrik të ri (TEP). Në kushtet kur Banka Botërore ka një portofol të kufizuar për Shqipërinë me fondet e Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, IDA, Banka inicioi bisedime me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) lidhur me bashkëfinancimin e TEP-it, dhe informoi Qeverinë në Janar të vitit 2002 se tre Institucione Financiare Ndërkombëtare (IFIs) ishin përgatitur për të ndihmuar Qeverinë për të rritur kapacitetin termal të prodhimit (rreth 100 MW kapacitet nominal). Një firmë e njohur konsulente në nivel ndërkombëtar përgatiti studimin e fisibilitetit për TEP-in e propozuar, e financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (USTDA) në vitin 2002. Ajo përgatiti gjithashtu vlerësimin mjedisor të projektit në vitin 2003<sup>3</sup>. Vlerësimi i Projektit filloi në Nëntor të vitit 2003, duke i kushtuar vëmendje të veçantë aspektit ekonomik, teknik, institucional dhe tregtar të projektit, si edhe impaktit të tij social.<sup>4</sup>

13. Projekti zë një vend të rëndësishëm në strategjinë e Zhvillimit të vendit. Strategjia e Zhvillimit dhe Uljes së Varfërisë (GPRS, më pas e quajtur Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social– NSSED), Vlerësimi i Përbashkët i IDA-IMF për GPRS, si dhe Strategjia e Asistencës për vendin (CAS), në të cilën projekti është përfshirë si një investim prioritar janë prezantuar në Bord në Qershor të vitit 2002. GPRS dhe CAS theksuan impaktin makroekonomik të krizës energjetike, ndikimin e saj mjaft të madh tek të varfrit dhe rëndësinë e madhe të trajtimit të shkaqeve të krizës dhe plotësimit të nevojave për investime prioritare. NSSED theksoi zbutjen e krizës energjetike si një faktor kyç për rritjen ekonomike. Midis masave të propozuara për sektorin e energjisë në periudhën afatshkurtër ishin zbatimi i projektit të termocentralit me cikël të kombinuar në Vlorë, ulja e mëtejshme e humbjeve në rrjet, rritja e arkëtimeve, ristrukturimi i Korporatës Energjetike Shqiptare (KESH) dhe krijimi i kushteve për përfshirjen e sektorit privat në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë.

14. Në Janar të vitit 2003, Komisioni Evropian dhe Shqipëria nisën negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Ky proces i dha Shqipërisë një nxitje të

---

<sup>3</sup> Banka ka zhvilluar një diskutim të brendshëm nëse vlerësimi mjedisor duhet të kryhej nga e njëjta kompani e cila përgatiti studimin e fisibilitetit. Duke pohuar që firma ishte e aftë të kryente këtë punë, është vërejtur se në përputhje me politikën e Bankës për Vlerësimet Mjedisore, firma nuk po kryente ndonjë “studim inxhinierik” (Krahas kësaj firma nuk do të angazhohej në ndonjë ndërtim të mëvonshëm). Megjithatë për të përforcuar natyrën objektive të Vlerësimit Mjedisor u vendos që të kryhej një rishikim tjetër i pavarur i Vlerësimit Mjedisor. Kjo u realizua gjatë periudhës Shtator -Tetor 2003.

<sup>4</sup> Sipas Kërkesave të OMS 2.20, Vlerësimi i Projektit.

rëndësishme për të reformuar institucionet e saj, duke përfshirë edhe ato të sektorit të energjisë në përputhje me Kërkesat e Komunitetit Evropian. (EU). Një problem i rëndësishëm, si në perspektivën rajonale edhe atë kombëtare ishte nevoja që sistemi i Shqipërisë të lidhej në Unionin për Koordinimin e Transmetimit të Energjisë Elektrike (UCTE), shoqatë e operatorëve të sistemit të transmetimit në Evropën kontinentale. Shqipërisë iu kërkua plotësimi i disa kushteve për të qenë pjese e këtij Unioni. Një projekt marrëveshje është negociuar me mbikëqyrjen e UCTE me prodhuesit e energjisë elektrike të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Dhënia për shfrytëzim (commissioning) e termocentralit të Vlorës ishte një nga këto kushte. Kjo marrëveshje u nënshkrua në vitin 2004.

15. Projekti do të jetë centrali i parë i ri i prodhimit të energjisë që nga koha kur hidrocentrali i Fierzës nisi prodhimin në vitin 1987. Bazuar në vlerësimin e sasisë ofruar nga prodhues të ndryshëm, tenderat janë organizuar për kapacitet nga 85 MW deri në 135 MW. Kontrata u dha për një termocentral me kapacitet 97 MW. Centrali pritet të sigurojë rreth 680 GWh në vit (me një disponueshmëri prej 80 %). Kur u kontraktua, ai u vlerësua të mbulonte rreth 20% të deficitit të furnizimit me energji në një vit hidrologjik mesatar dhe një pjesë shumë më të vogël në një vit të thatë. Ndërtimi i një termocentrali në pjesën jugore të vendit do të zvogëlonte humbjet teknike dhe përmirësonte ndjeshëm sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji në të gjithë vendit dhe veçanërisht në pjesën jugore, ku niveli i shërbimit është shumë më i ulët.

16. Projekti përfshin:

- (i) një stacion me cikël të kombinuar që funksionon me naftë të distiluar me nivel shumë të ulët sulfuri në një sipërfaqe prej 6 ha në veri të qytetit të Vlorës afër një terminali depozite naftë;
- (ii) asistencë teknike për:
  - Vlerësimin e tenderit, administrimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projektit;
  - ngritjen e një kompanie filial të KESH-it për të zotëruar dhe vënë në funksionim centralin, përgatitjen e një marrëveshje për blerjen e energjisë dhe asistencë për blerjen e shërbimeve të një operatori për periudhën fillestare ;
  - studimin që kërkohet nga Plani i Grupi i Menaxherëve Mjedisorë (EMP);
  - analizimin e alternativës së kërkimit të ofertave për sigurimin e gazit për këtë stacion;
  - reformën në sektorin e energjisë;
  - vëzhgime për nivelin e shërbimit të konsumatorëve;
  - përmirësimet në kontrollin e inventarit; dhe
  - trajnime për prokurim dhe menaxhim mjedisor.

17. Projekti do të përdorë një turbinë gazi me cikël të kombinuar (CCGT) për prodhimin e energjisë. Kjo është një teknologji që dominon në investimet për stacionet më moderne të energjisë, sepse ajo arrin një eficiencë shumë më të lartë sesa alternativat për prodhimin e energjisë termale të kombinuar me shkarkime shumë të vogla në ajër.

Teknologjia CCGT është përdorur së pari me gaz natyror si karburant por, në kushtet e mungesës së gazit natyror në Shqipëri në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, stacioni do të vihet në punë me naftë të distiluar. Specifikimet e karburantit për stacionin sigurojnë përmbajtje të ulët sulfuri të naftës së distiluar me qëllim reduktimin e shkarkimeve në ajër, megjithëse kjo e rrit koston operacionale. *“Përmbajtja sulfurike e karburantit do të monitorohet për t’u siguruar që është më pak ose i barabartë me 0.1% të peshës. Nxjerrja e mostrës dhe analizat duhet të kryhen në çdo rast.”*<sup>5</sup> TEP është projektuar për të lejuar konvertimin në gaz natyror nëse dhe kur ai të importohet në Shqipëri.

18. Shuma e përgjithshme e financimit të kontratës për TEP pritet të jetë 92 milion EUR (afërsisht 123.3 milion USD). Në bazë të kontratës Inxhinierike, Prokuruese dhe të Ndërtimit (EPC) kosto e projektit të stacionit të energjisë përfshin rreth 10 milion EUR për: (i) terminalin e depozitës së karburantit larg bregut; (ii) një tubacion nën det; dhe (iii) fasilite të ruajtjes së karburantit. Ajo përfshin gjithashtu 4.4 milion USD për një lidhje të sistemit të transmetimit të Shqipërisë në nënstacionin e Babicës 220/110 kv që ndodhet 7 km larg. Kosto e përgjithshme e projektit përfshin gjithashtu 4.85 milion USD për asistencë teknike dhe trajnime.

19. Financimi i projektit sigurohet nëpërmjet kredisë së Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim prej 25 milion USD dhe një huaje prej 40 milion EUR prej secilit (afërsisht 54 milion USD) financues, respektivisht nga EIB dhe EBRD. Të tri Institucionet Ndërkombëtare Financiare po sigurojnë një financim të përbashkët me shumë sesa një financim paralel, përderisa kemi një kontratë të vetme furnizimi dhe instalimi (EPC) për TEP.

20. Stacioni energjetik do të jetë në pronësi të një ndërmarrjeje të veçantë të korporuar, me të gjitha aksionet në pronësi të KESH-it, i cili do ta vërë atë në funksionim. Një marrëveshje për blerje energjie do të nënshkruhet midis kompanisë dhe KESH-it me një rregullim të garantuar merr-ose- paguaj për një periudhë të kufizuar kohe. Një marrëveshje e tillë siguron dy përfitime: së pari ajo përbën një precedent të vlefshëm për investime të ardhshme prodhimi nga sektori privat ose nëpërmjet një partneriteti publik privat; së dyti, një regjistër i performancës financiare të kompanisë filial me një marrëveshje të tillë do të lehtësonte privatizimin e saj në të ardhmen. Krahas kësaj, furnizimi i qëndrueshëm me energji të siguruar nga një prodhues i dedikuar është me përfitim për popullsinë.

21. Përfitimet e projektit konsistojnë në: (i) furnizim në rritje me energji elektrike nga stacioni i ri, i cili do të kontribuojë në një balancë të përmirësuar midis energjisë hidrike dhe asaj termale; (ii) kosto të shmangura të linjave të transmetimit dhe mbajtësve për të përmirësuar shërbimin e furnizimit me energji në jug të vendit; (iii) humbje më të vogla gjatë transmetimit në kushtet kur centrali do të ngrihet pranë zonave me kërkesë më të madhe për energji, të cilat aktualisht kanë furnizim të ulët; (iv) krijimin e mundësive për

<sup>5</sup> Nga EMP, e cila reformon Aneksin në kontratë (h), Aneksi 5. Referimi te tabela 8.4, faqe 21. Përdorimi i këtij karburanti me përmbajtje të ulët sulfuri duhet të jetë në përputhje me direktivën e KE 1999/32/EC e cila kërkon karburant të distiluar për të reduktuar përmbajtjen e sulfurit në 0.1% nga 1 Janar 2008.

lidhjen me sistemin UCTE ; (v) më pak ulje të ngarkesës që rezulton nga reduktimet e humbjeve jo teknike të energjisë dhe nga përmirësimi i arkëtimeve ndërkohë që të dyja çojnë në një kërkesë më të vogël dhe rritje të aftësisë së KESH-it për të përballuar importin e energjisë; (vi) performancë financiare më të mirë të sektorit të energjisë, e cila është rezultat i zvogëlimit të humbjeve në transmetim dhe shpërndarje, i rritjes së arkëtimeve dhe tarifave; dhe (vii) zbatimin nga Qeveria të një Strategjie të qartë të Reformës së Sektorit të Energjisë. Përveç kësaj, furnizimi më i qëndrueshëm me energji do të ndihmojë dhe mbështesë zhvillimin e turizmit në zonën e Vlorës dhe të gjithë Jugut.

22. KESH po menaxhon zbatimin e projektit nëpërmjet Njësisë së Grupi i Menaxherëve të Projektit, e cila ka punuar për zbatimin e Projektit të mëparshëm të Rehabilitimit dhe Ristrukturimit të Sektorit të Energjisë dhe që vazhdon të punojë edhe për projektin në fjalë.

#### VLERËSIMI EKONOMIK I PROJEKTIT DHE ANALIZA E ALTERNATIVAVE

23. Në bazë të kërkesave të Bankës lidhur me politikën e saj për Vlerësimin Ekonomik, analiza e alternativave u realizua si pjesë e procesit të vlerësimit të projektit.<sup>6</sup> U morën në konsideratë katër alternativa për projektin: (i) të mos ketë projekt; (ii) një projekt tjetër transmetimi dhe shpërndarjeje; (iii) variante alternative të karburanteve dhe zonave; dhe (iv) një projekt i pavarur i energjisë (IPP) i financuar nga një investitor privat.

24. **Të mos ketë projekt.** Një alternative në vend të TEP të propozuar do të kishte qenë importi i një sasive shtesë energjie elektrike, e cila do të kompensonte sasinë që do të prodhohej nga stacioni. Shqipëria ishte mjaft e varur nga importi i energjisë elektrike dhe kjo varësi do të vazhdonte të rritej. Pa prodhim të brendshëm shtesë, prodhimi aktual i vendit do të plotësonte vetëm 44% të kërkesës në vitin 2015 në një vit hidrologjik mesatar dhe 33% në një vit të thatë. (3,000 GWh prodhim i brendshëm). Duhet shtuar fakti se rajoni kishte mangësi në furnizimin me energji. Pra importimi do të bëhej gjithnjë e më i vështirë dhe më i shtrenjtë. Shqipëria blinte energji elektrike bazuar në kontrata 1 vjeçare ose më të shkurtra dhe nuk ishte në gjendje të siguronte kontrata më të gjata. Mungesa e importeve të mjaftueshme do të kishte një impakt makroekonomik shumë negativ. Sigurimi i kapaciteteve shtesë të prodhimit të brendshëm do ta vinte Shqipërinë në kushte më të favorshme.

25. Projekti i Interkonjeksionit Ndërkombëtar, Transmetimi dhe Shpërndarja Alternativa e një projekti të ri të mbështetur nga IDA për të forcuar lidhjet e transmetimit me vendet fqinjë u konsiderua si e panevojshme derisa financimi për një lidhje në Veri me një linjë 400 kV ishte kryer nga KfW dhe Italia. Norma e Brendshme Ekonomike e Kthimit e këtij interkonjeksioni ishte më e ulët sesa ajo e TEP-it të propozuar për t'u ndërtuar në Vlorë. Alternativa e një tjetër projekti për të rehabilituar dhe forcuar sistemet

---

<sup>6</sup> Për më shumë hollësi shih gjithashtu : Dokumentin e Vlerësimit të projektit, 17 Shkurt, 2004, Nr i Raportit: 27049-ALB.

e shpërndarjes në rajonet e zgjedhura të Shqipërisë së bashku me investimet e asociuara të transmetimit u mor në konsiderate. Kjo alternativë u vlerësua duke përdorur një analizë të hollësishme kosto-përfitim të shpërndarjes së energjisë dhe investimeve të asociuara duke i dhënë prioritetin më të lartë studimit të Sektorit të Energjisë dhe u parashikua të zbatohet përpara vitit 2006. Norma e Brendshme Ekonomike e Kthimit për këtë alternativë, ndonëse e favorshme, ishte më e ulët se ajo e Termocentralit të Vlorës, dhe Vlera Aktuale Neto (NPV) ishte ndjeshëm më e vogël.

26. Karburantet dhe Zonat alternative.<sup>7</sup> Studimi i fisibilitetit të projektit mori në konsideratë zona dhe karburante alternative përkundrejt përdorimit të naftës së distiluar në një njësi prodhuese me cikël të kombinuar në Vlorë (zona B). Zonat e tjera, të cilat u studiuan ishin: Durresi, Elbasani, Fieri, Korca, Shëngjini dhe Vlora (zona A).

27. Alternativa me gaz natyror dhe cikël të kombinuar në secilën zonë ishte më e kushtueshme sesa alternativa e naftës së distiluar, derisa, në kushtet e mungesës të ndonjë konsumatori tjetër të fuqishëm të gazit në kohën kur centrali do të niste punën, kosto totale e ndërtimit të infrastrukturës së importi të gazit do të ishte pjesë e koston së projektit të propozuar TEP. Megjithatë, nëse dhe kur gazi natyror i importuar të sillet në Shqipëri TEC i Vlorës do të konvertohet në përdorimin e gazit. Djegësit e naftës në turbinat e djegies do mund të djegin gaz natyror, pa kosto shtesë për projektin ndonëse do të ketë kosto shtesë për linjat e gazit natyror, si dhe pajisjet e kompresimit, trajtimit dhe nxehtësisë së gazit.

28. Varianti i përdorimit të qymyrit të vendit në një stacion konvencional të qymyrit është përjashtuar për shkak të koston së lartë të rihapjes së minierave të qymyrit, problemeve të ndotjes për shkak të përmbajtjes së lartë sulfurike, mungesës së sistemit të përshtatshëm të transportit dhe fuqisë kalorifike të ulët. Alternativa e importit të qymyrit do të ishte më e kushtueshme sesa ajo e naftës së distiluar.

29. Përdorimi i naftës së rëndë (HFO) në një central me cikël të kombinuar do të ishte më i lirë sesa nafta e distiluar, por djegia e HFO me nivel të ulët sulfur (më pak se 1%) nuk do të sjellë kursime, për shkak të performancës së ulët. Përdorimi i naftës së rëndë me nivel të lartë sulfur (më shumë se 1%) do të kishte zvogëluar koston e niveluar (levelized) me rreth 6%, por do të ishte shoqëruar me shkarkime të larta dhe afërsisht do të emetonte dyfishin e shkarkimeve të NO<sub>x</sub> dhe SO<sub>x</sub>. Duke pasur parasysh argumentet e mësipërme, HFO nuk u konsiderua si i përshtatshëm për projektin.

30. Nga ana tjetër, zonat (e mundshme për ndërtimin e TEP) janë vlerësuar mbi bazën e 10 kriterëve, ku secili kishte një peshë specifike të veçantë. Kriteret dhe pesha e tyre ishin si në vazhdim: (i) përmirësimi i kushteve mjedisore – 12 përqind; (ii) problemet e cilësisë së ajrit – 8 përqind; (iii) kosto e niveluar – 12 përqind; (iv) problemet socio ekonomike – 8 përqind; (v) zvogëlimi i humbjeve në sistemin e transmetimit dhe përmirësimi i voltazhit – 12 përqind; (vi) mundësia e transmetimit dhe afërsia – 10

---

<sup>7</sup> Shih studimet e konsulentit, “Studimi Përfundimtar i Fisibilitetit” dhe “Studimi i Zonave të mundshme të ndërtimit,” Tetor, 2002.

përqind; (vii) disponueshmëria e naftës – 14 përqind; (viii) nevojat për ujë dhe kanalizime – 10 përqind; (ix) transportimi – 8 përqind; dhe (x) pronësia – 6 përqind. Zonat e Vlorës dhe Fierit ishin më të mirat përsa i përket perspektives së transmetimit, sepse ato mund të përmirësonin ndjeshëm nivelin e voltazhit në gjithë sistemin e vendit, mund të ulnin shumë numrin e nënstacioneve me voltazh të ulët, mund të zvogëlonin humbjet në sistem dhe do të kishin kosto të arsyeshme të lidhjes.

31. Avantazhe të tjera të zonës së Vlorës ishin mundësia e përdorimit të ujit të detit për eliminimin e nxehtësisë së ciklit të avullit nëpërmjet ftohjes dhe mundësia e shfrytëzimit të portit për pajisjet e importuara për TEP. Zonat e Durrësit dhe Elbasanit ofronin përfitime lidhur me perspektivën e voltazhit dhe humbjeve, por jo në nivelin ofruar nga zonat e Vlorës dhe Fierit. Zonat e Korçës dhe Shëngjinit siguronin përmirësime marxhinale të voltazhit dhe reduktimit të humbjeve, po ato vuanin nga kufizime të tjera si kosto e lartë e karburantit dhe vështirësi në transportin e materialeve. Zona Vlorë A, e cila ndodhet 4 km në perëndim të qytetit përfshin pjesë të një uzine të braktisur kimike, e cila është burim i një ndotjeje të madhe mërkuri si dhe të mbetjeve të tjera kimike. Masat e nevojshme për të zgjidhur problemet mjedisore kishin një kosto shumë të lartë.<sup>8</sup> Disavantazhi i zonës së Fierit në krahasim me zonën Vlorë B ishte kosto ekstra për transportimin e naftës së distiluar të importit nga Vlora në Fier si edhe problemet mjedisore që lidheshin me të. Ekziston një lidhje e ngushtë midis renditjes së zonave në bazë të dhjetë kriterëve dhe renditjes së tyre vetëm në bazë të koston së niveluar. Në të dyja rastet zona e rekomanduar e Vlorës është renditur e para në krahasim me Fierin.

32. IPP. Alternativa e IPP u hodh poshtë në dritën e mundësisë shumë të ulët që investitorë private të interesoheshin për investim në një stacion të ri energjie për tregun shqiptar për shkak të një sere faktorësh. Ndër këto faktorë mund të përmenden: zvogëlimi në nivel botëror i interesit për investime në sektorin e energjisë, vështirësitë financiare me të cilat po përballen disa investitorë potencialë dhe risqet e perceptuara për Shqipërinë.

33. Studimi i Fisibilitetit vlerësoi Vlerën Ekonomike Neto dhe Normën e Brendshme të Kthimit për madhësi dhe lloje të ndryshme uzinash me cikël të kombinuar në zonën Vlorë B. Vlerësimet e përdorura për Dokumentin e Vlerësimit të projektit janë për një uzinë, e cila do të ketë dy turbina djegieje dhe një turbinë me avull, me një kapacitet të instaluar prej 131 MW, me prodhim vjetor 921 GWh, dhe jetëgjatësi prej 20 vjetësh.

34. Gjatë vlerësimit të projektit dhe kryerjes së analizave ekonomike, kosto përfshinte koston e investimit, e cila vlerësohet të jetë 102 milion USD (duke përfshirë të papriturat

---

<sup>8</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) ka realizuar vrojtime në zonë dhe analiza të riskut në vitin 2000, të cilat e kanë përcaktuar zonën si “hot spot” që paraqet rreziqe për shëndetin e popullatës dhe mjedisin. Sipas UNEP, uzina e mëparshme kimike ka përdorur sasi të shumta mërkuri në operacionet e saj të elektrolizës klorin, acide dhe sasi të konsiderueshme mërkuri janë humbur gjatë prodhimit duke shkaktuar ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësore. Raporti jep një sërë rekomandimesh për reduktimin e rrezikut ndaj shëndetit të njerëzve dhe bën një përshkrim të karakteristikave të zonës. Shih programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe të Agjencisë Shqiptare të Mjedisit, 2000. *Vlerësimi Mjedisor Pas Konfliktit dhe Statusi i Raportit Mjedisor*. ISBN 82-7701-014-1, e vlefshme edhe në CD.

fizike prej 5% (shpenzime të paparashikuara) por jo shpenzimet e paparashikuara, kostot vjetore të karburantit dhe kostot vjetore të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Përfitimet me madhësi të përcaktuar përfshijnë: (i) çmimin me pakicë të vlerësuar në bazë të dëshirës së konsumatorëve për të paguar më pak për kostot e transmetimit dhe shpërndarjes dhe humbjet; (ii) zvogëlimin i humbjeve gjatë transmetimit në sistemin shqiptar, të cilat i kalohen projektit në 46 GWh në vit të vlerësuara me gatishmërinë për të paguar; (iii) shpenzimet e shmangura që arrijnë 27.9 milion USD në një linjë transmetimi 220 kV nga Tirana 2 në Durrës dhe në Fier dhe në linjë transmetimi 220 kV nga Elbasan 1 në Fier; dhe (iv) investimet e shmangura që arrijnë në 1.7 milion USD në 100 MVAR të kapaciteteve mbajtëseve. Gatishmëria për të paguar 0.109 USD për kWh është vlerësuar mbi bazën e koston mesatare të konsumit të prodhimeve alternative diesel në vendndodhjet e konsumatorëve për konsumatorë të vegjël e të mëdhenj industrial dhe tregtar, ku pesha më e madhe lidhet me rritjen e konsumit prej këtyre dy konsumatorëve. Kërkesa shtesë e parashikuar për periudhën 2003-2008 për këto grupe konsumatorësh e kapërcen pak prodhimin e TEP së Vlorës. Analiza e koston dhe përfitimit ka llogaritur Vlerën Aktuale Neto prej 118 milion USD dhe Normën Ekonomike të Kthimit në nivelin 37 %.

#### STATUSI I PROJEKTIT

35. Projekti ishte aprovuar nga Bordi i Bankës Botërore në 16 Maj 2004. Dokumentet zyrtare janë firmosur ne 6 Prill, 2004 dhe Projekti u bë efektiv ne 25 Janar, 2005. Pas procesit të tenderimit i cili u zgjat nga nevoja për të kontrolluar me kujdes problemet komplekse që lindin gjatë vlerësimit të ofertave, kontrata e EPC për TEP u firmos ne 9 Shkurt 2007 dhe u bë efektive në 5 Maj, 2007. Punimet civile pritet të fillojnë në Qershor 2007.

36. Misione të rregullta mbikëqyrje janë kryer nga grupi i projektit <sup>9</sup> pas aprovimit të tij nga Bordi i Bankës Botërore. Banka ka pasur korrespondencë me shoqërinë civile, duke nisur nga Qershori i vitit 2005 ku janë ngritur shqetësime lidhur me projektin. Grupi i Projektit i analizoj shqetësimet dhe ktheu përgjigje me shkrim. Menaxheri i Vendit dhe Drejtori për Shqipërinë zhvilluan në Prill të vitit 2006 një takim me përfaqësues të shoqërisë civile ku diskutuan shqetësimet e tyre, ndërkohë që një mision i veçantë erdhi në Shqipëri për të marrë më shumë informacion lidhur me problemet kulturore. (Shih gjithashtu Anekset 1 dhe 2 për më shumë hollësi).

#### IV. PROBLEME QË LIDHEN ME MASAT MBROJTËSE

##### SIGURIMI I PËRPTHJES ME POLITIKAT E BANKËS BOTËRORE DHE INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE FINANCIARE

---

<sup>9</sup> Shih raportet e statusit të Zbatimit që nga 9/29/2004.

37 Banka Botërore, EBRD dhe EIB kërkojnë nga huamarrësi një përputhje me politikat e ndryshme të “masave mbrojtëse” për të siguruar standardet mjedisore dhe sociale që duhen plotësuar.<sup>10</sup> Duke ditur projektin e mundshëm të TEP së propozuar politika kryesore e të tre institucioneve është gjykuar të jetë Vlerësimi Mjedisor. (VM, i mbuluar nga OP 4.01 sipas sistemit të Bankës Botërore). Ndërkohë që Shqipëria kishte ligje në fuqi për Vlerësimin Mjedisor, eksperiencia e vendit (me aftësi për financim) për të përgatitur VM për investime kaq të mëdha ishte shumë e kufizuar. USTDA dha mbështetje për të marrë konsulentë në përgatitjen e Vlerësimit Mjedisor dhe vlerësimet e lidhura me të. Këto vlerësime ishin në përputhje me Kërkesat e secilit nga tre institucionet ndërkombëtare financiare dhe rregullat përkatëse shqiptare. USTDA lehtësoj një kontratë midis konsulentit dhe Qeverisë Shqiptare (e firmosur në 10 Prill 2002) për të kryer punën lidhur me VM krahas mbështetjes për fisibilitetin dhe vendin e mundshëm ku do të bëhet ndërtimi

38. Analizat krahasuese të 21 zonave në 7 lokalitete për një TEP të ri i kushtuan vëmendje faktorëve mjedisor dhe social, veçanërisht (i) nivelit të përmirësimit të kushteve mjedisore të nevojshme për të përgatitur zonën; (ii) problemet lidhur me cilësinë e ajrit; (iii) nevojat për ujërat dhe kanalizimet; dhe (iv) problemet socio – ekonomike që përfshijnë afërsinë me zonat e mbrojtura dhe delikate. Këto dhe renditjet e tjera sasiore çuan në rekomandimin se duhet vazhduar me analiza të mëtejshme në zonën e Vlorës B; së pari në mënyre paraprake në projekt studimin ( 6 Qershor, 2002) dhe më pas me studimin përfundimtar të datës 21 Tetor 2002. Projekt studimi i Fisibilitetit (6 Gusht 2002) përfshinte një Analizë të Hollësishme Paraprake Mjedisore (EA). Gjetjet u diskutuan në një takim publik në Vlorë në 31 Tetor 2002.<sup>11</sup> Në vazhdim të identifikimit të zonës Vlora B si kandidati kryesor për ndërtimin e centralit të propozuar, puna për masat mbrojtëse filloi me studimin që siguroi informacionin, i cili u inkorporua në pjesën e “alternativave” në raportin e VM.

39 Procesi formal i Bankës Botërore për përputhjen e masave mbrojtëse nisi në fillim të Tetorit 2002 me mbledhjet e para të brendshme për të përcaktuar kërkesat e masave mbrojtëse në fazën e konceptimit. Projektit i është dhënë vlerësimi si “Kategori A” për VM, duke njohur efektin potencial të rëndësishëm në mjedis dhe nevojën për masat zbutëse dhe monitoruese. Kjo ishte në përputhje me sistemet e vlerësimit të EBRD dhe EIB (të dyja të bazuara në direktivën e VM të Komisionit Evropian). Kategoria A e vlerësimit përcaktohet nga komponenti i riskut më të lartë, risku që paraqet vetë TEP-i, i cili kërkonte një VM të plotë sipas politikave dhe procedurave të Bankës Botërore si edhe të EBRD<sup>12</sup> dhe EIB.<sup>13</sup> Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndikimit në cilësinë e ajrit nga shkarkimet e oxhaqeve, cilësisë së ujit nga derdhjet e ujit të ftohtë, dhe ndikimeve të tjera plotësuese në Lagunën e Nartës, e cila shtrihet rreth 2 km nga zona e projektit. Dihet

<sup>10</sup> Politikat e Bankës Botërore mund të gjenden në faqen e jashtme të web-it të Bankës:  
<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/PROJECTS/EXTPOLICIES/EXTSAFEPOL/0,,menuPK:584441~pagePK:64168427~piPK:64168435~theSitePK:584435,00.html>

<sup>11</sup> Vini re se disa projekte e kanë këtë takim në 28 Tetor.

<sup>12</sup> Politikat e EBRD mund të gjenden në <http://www.ebrd.org/nviro/policy/index.htm>.

<sup>13</sup> Një pamje e përgjithshme lidhur me metodën e EIB për mjedisin është e vlefshme në:  
<http://www.eib.org/environment/index.htm>.

gjithashtu se natyra e kontratës së EPC nënkuptonte risqe shumë të lokalizuara, ndikimet dhe masat zbutëse duhet të sqaroheshin më shumë në momentin kur projekti specifik të ishte përcaktuar dhe të dhëna të mëtejshme të ishin marrë lidhur me cilësinë e ajrit në ambient. Komponentë të tjerë të projektit, të cilët shkaktojnë impakte të mundshme që mund të zbuten gjatë zbatimit përfshijnë përmirësimin e menaxhimit të naftës, vendndodhjen e hyrjes larg bregut të furnizimit me ujë të ftohtë, përmirësimin e aksesit në rrugët rurale për të kontrolluar ndërtimin dhe menaxhimi i mbeturinave në zonën e ndërtimit. .

40. Diskutime të brendshme plotësuese lidhur me metodën e vlerësimit u organizuan nga Tetori i vitit 2002 deri në fillim të Janarit të vitit 2003. Njoftimi Publik Zyrtar në lidhje me qëllimin e Bankës për të përgatitur projektin u realizua në 2 Janar të vitit 2004 me publikimin e Dokumentit Informativ të (PID) në InfoShop. Një përmbledhje e metodës fillestare lidhur me masat mbrojtëse (siç kërkohet nga politika e Bankës) u vendos në 19 Shkurt 2003 në InfoShop të Bankës si pjesë e Fletëve të të Dhënave të masave mbrojtëse të Integruara.(ISDS). Politikat kryesore për masat mbrojtëse që janë analizuar për përshtatshmëri sipas procesit të VM (OP 4.01) përfshijnë Habitatet Natyrore (OP 4.04), për shkak të afërsisë me Lagunën e Nartës (në atë kohë e përcaktuar për mbrojtje) dhe Migrimit të Detyrueshëm (OP 4.12) për arsye të nevojës së mundshme për të marrë tokë që nevojitej për kullat e linjave të transmetimit. Gjatë rishikimit të Projektit dhe pas konsultimeve me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin për zonën e mbrojtur rreth lagunës së Nartës, u arrit në përfundimin se ndikimet potenciale mbi Habitatet Natyrore (OP 4.04) nuk do të ishin të mëdha, ndaj masat mbrojtëse nuk u aktivizuan.

41. Projekti ndoqi procedurat standard të Bankës Botërore për një Projekt të kategorisë A që përfshijnë: (i) Konsultimet publike nga Qeveria në fazën e hershme të përgatitjes së VM në 2 Prill, 2003 dhe një projekt raport të VM në 3 Shtator 2003; (ii) lajmërimin e mëparshëm të aktorëve për këto takime të Qeverisë; (iii) procesin e një oponente të brendshme të Bankës Botërore dhe Institucioneve Ndërkombëtare Financiare për projekt dokumentet dhe dokumentet përfundimtare; (iv) zgjidhjen e komenteve nëpërmjet plotësimit të raporteve përfundimtare dhe të një dokumenti Shtesë; (v) hedhjen në faqen e internetit të projekt Vlerësimit Mjedisor në Shqipëri (në Shqip) dhe në Info Shop (në Anglisht) në përputhje me Politikën e Bankës për Dhënien e Informacionit (Volum1 në 6 Tetor , 2003 dhe Volumn 2 të Shtesës be 15 Janar, 2004); dhe (vi) kuadrin e politikës për Marrjen e Tokës në dokumentet e VM.<sup>14</sup> Krahas kësaj, një firmë e njohur konsulente i ka bërë oponentin Vlerësimit Mjedisor. Oponenti është realizuar me financimin e Qeverisë Kanadeze si një masë ekstra për cilësinë e VM.

42. Raportet e Vlerësimit Mjedisor (sipas politikës së Bankës) përfshijnë seksionet e integruara të EMP, të cilat përcaktojnë Kërkesat për lehtësimin dhe monitorimin e procesit gjatë ndërtimit dhe fazës operacionale. Këto dispozita u inkorporuan në atë kohë në specifikimet e projektit për pjesëmarrësit në tender. Qeveria u angazhua në

---

<sup>14</sup> Kuadri i politikës u përgatit dhe u hodh në Anglisht vetëm prej vendimit fillestar se marrja e tokave private nuk ishte e mundur.

respektimin e këtyre Kërkesave gjatë zbatimit të projektit, dhe një firmë e njohur ndërkombëtare (e pavarur nga firma e cila përgatiti studimin e parë) është angazhuar për të mbështetur zbatimin e EMP-se në katër drejtime: (i) azhornimin e vlerësimit të ndikimit mbi cilësinë e ajrit duke përdorur të dhëna specifike të cilësisë së ajrit dhe të monitorimit meteorologjik; (ii) trajnimin e personelit të Njësisë së Menaxhimit Mjedisor të KESH-it për aftësimin e tyre në mbikëqyrjen e zbatimit të EMP-së; (iii) rishikimin e parandalimit të derdhjes së naftës dhe planin e masave që duhen marrë për projekte specifike të zgjedhura nga kontraktuesi i EPC ; dhe (iv) në përgatitjen e një VM Plotësuese për të gjitha studimet e përfshira në hapësirën e kontraktuesit. Monitorime shtesë të cilësisë së ajrit dhe kushteve meteorologjike lokale janë realizuar duke nisur nga Shkurti i vitit 2002 për të mundësuar rikonfirmimin e rezultateve të studimeve mbi shkarkimet. Hollësi të mëtejshme jepen në kronologjinë e zgjedhur të përfshirë në Aneksin 2.

43. Kërkesat për masat mbrojtëse të Bankës Botërore janë trajtuar gjatë përgatitjes së Projektit dhe nuk ka pasur përjashtime të politikës në Dokumentin e Vlerësimit të projektit ose të paraqitura në Bord. Lidhur me Kërkesat e Institucioneve të tjera Ndërkombëtare Financiare, EBRD dhe EIB që mbështeten në të njëjtat dokumentacione si edhe BB, Banka Evropiane e shpërndau VM për të plotësuar Kërkesat në 6 Shkurt 2004 dhe la një periudhë për komente prej 120 ditësh, duke filluar nga 8 Shkurt deri në 8 Korrik 2004.<sup>15</sup> Bordi i Bankës Evropiane e miratoj projektin në 8 Korrik 2004. Krahas kësaj, Qeveria e Shqipërisë ka konfirmuar respektimin e legjislacionit shqiptar në të gjitha Kërkesat ligjore të projektit (shih përgjigjen e Qeverisë për Konventën Aarhus). Grupi i Menaxherëve vëren se Aprovimi kryesor Mjedisor dhe Liçensa janë nxjerrë që në Mars të vitit 2007.

44. Aleanca Qytetare i dërgoi një letër Bankës në Qershor të vitit 2005 ku ngrinte argumente teknike, ligjore dhe ekonomike kundër projektit. Duke filluar nga Janari i vitit 2006, Banka ka marrë letra lidhur me plotësinë e të dhënave për trashëgiminë kulturore në dokumentin origjinal të VM. Rishikimi i brendshëm i Bankës sugjeroi që ky problem specifik duhet të shihet nga një grup i specializuar dhe kjo u realizua në Korrik të vitit 2006. Rishikimi (Aneksi 3) si proces përfshinte një vizitë në zonë dhe diskutime me ekspertë të njohur dhe u konfirmua se projekti është në përputhje me politikën relevante të Bankës (OPN 11.03 në kohën kur u bë rishikimi) dhe me ligjet e rregulloret përkatëse të vendit lidhur me pasuritë historike dhe kulturore. Monitorimi i gërmimeve gjatë ndërtimit të stacionit dhe punimet civile të lidhura me të, për të identifikuar dhe mbrojtur “gjetjet e rastit” u konsiderua si i vetmi veprim që duhej kryer në përputhje me praktikën e përcaktuar të Bankës, dhe kjo është marrë parasysh në kontratën me EPC-në.

#### MANGËSITË E SUPOZUARA NË LIDHJE ME RESPEKTIMIN E POLITIKËS SË BANKËS PËR MASAT MBROJTËSE

45. Kërkuesit kanë ngritur disa shqetësime për projektin të cilat Grupi i Menaxherëve i konsideron si çështje të lidhura me respektimin nga projekti të politikave të Bankës

<sup>15</sup> Përmbledhja e tyre është e vlefshme në : <http://www.ebrd.org/projects/eias/33833.pdf>

Botërore në lidhje me masat mbrojtëse. Tema e parë është shumë e gjerë dhe e fokusuar në pak tema mjedisore dhe sociale: “Nëse ndërtohet, TEPP në Vlorë do të shkatërroj në mënyrë të pariparueshme mjedisin, turizmin, peshqit, habitatet natyrore, ekosistemin, kolonitë korale si edhe pasurinë historike dhe kulturore të gjithë Gjirit të Vlorës dhe Lagunës së Nartës. Me pak fjalë, kjo do të shkatërroj të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë”. Grupi i Menaxherëve vëren se zbatimi i politikave të Bankës për masat mbrojtëse është mjeti me të cilin ndikimet potenciale të projekteve të investimeve në këto zona kontrollohen në mënyrë sistematike si pjesë e përgatitjes së projektit dhe e procesit të vendimmarrjes. Projekti në fjalë është klasifikuar si Kategori A për Vlerësimin Mjedisor sepse ky ishte mendimi i Grupit të Menaxherëve (si edhe i Institucioneve të tjera Ndërkombëtare Financiare) që projekti mund të paraqiste potencialisht impakte të ndjeshme mjedisore dhe sociale. Mendimi i Grupit të Menaxherëve është se nëpërmjet procesit të VM risqet mjedisore dhe sociale të projektit mund të shmangen, zbuten, monitorohen dhe kontrollohen me sukses.

46. Siç është përmendur më parë, nevoja prioritare për të rritur kapacitetin prodhues të energjisë në vend nënkuptonte se Shqipëria si edhe partneret e saj financiare ndërkombëtarë kërkonin një metodë të përgatitjes së projektit i cili duhet të jepte alternativa të shëndosha teknike në kohën e duhur duke respektuar standardet e Bankës (si edhe të EBRD & EIB) për cilësi dhe saktësi. Në të vërtetë rritja e parashikuar e turizmit do të rris kërkesën për energji elektrike, duke mbështetur më tej nevojën për investime në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike. Fatmirësisht, USTDA arriti të angazhonte një firmë ndërkombëtare konsulente e njohur për të përgatitur studimet e para fisibilitetit, si edhe dokumentacionin e nevojshëm të saktë mjedisor dhe social. Afati kohor për këtë proces ishte një sfidë e vërtetë dhe përbëhej nga dy faza: së pari, përcaktimi prioritar i zonave duke nisur nga Prilli deri në Nëntor të vitit 2002 dhe, së dyti, përgatitja dhe përfundimi i të gjithë VM dhe veprimeve të lidhura me të për zonën e klasifikuar e para (Vlore B) në periudhën Janar 2003 deri Janar 2004. Grupi i Menaxherëve vëren se Ankuesi në mënyrë direkte dhe të nënkuptuar ngre pyetje për përzgjedhjen e zonës, si në fazat e hershme dhe në lidhje me ndonjë investim të lidhur me të. Paragrafi në vazhdim e trajton këtë pyetje në hollësi.

#### ZGJEDHJA E ZONËS DHE LIDHJET ME INVESTIME TË TJERA

47. Siç është përmendur më lart, shtatë vendndodhjet kandidatë për ndërtimin e TEP ishin vlerësuar mbi bazën e disa faktorëve mjedisor dhe social. Grupi i Menaxherëve vëren se nuk ekzistojnë metoda të standardizuara ndërkombëtare për të kryer të tilla klasifikime dhe se vlerësues të tjerë mund të kenë përdorur faktorë dhe përqindje përkatëse të ndryshme. Grupi i Menaxherëve është i mendimit, megjithatë, se metoda e përdorur për këtë projekt reflekton praktikën e përshtatshme dhe të pranueshme profesionale. Prezantimi i rishikimit në Tetor të vitit 2002 në mbledhjen për konsultim publik në Shqipëri ishte një nga angazhimet e para të Qeverisë me shoqërinë civile në një fazë të hershme të një projekti kaq të madh investimi.

48. Si një projekt i Kategorisë A, projekti përfshin konsultime publike në fazën e përgatitjes së VM në Prill të vitit 2003 si edhe në fazën e raportimit të projekt VM-së në Shtator të vitit 2003. Njoftimet për këto mbledhje konsultuese u kryen nga Qeveria, dhe

proces verbalet e tyre janë përfshirë në raportin final të VM. (Tetor 2003). Secili nga këto takime dhe raporti i VM së i referohen alternativave të kontrolluara në fazat e mëparshme të studimit të para fisibilitetit dhe fisibilitetit në gjysmën e dytë të vitit 2002, një proces, i cili çoj në rekomandimin e zonës së Vlorës. Analiza e alternativave përfshiu një gamë të gjerë kriteresh analitikë, që përfshijnë përshtatshmërinë me mjedisin. Ka rëndësi të përmendet se Bankës nuk i janë paraqitur kundërshtime madhore lidhur me përzgjedhjen e këtij vendi gjatë procesit të VM që në Prill të vitit 2003 deri në momentin e aprovimit nga Bordi.

49. Ankuesi ka shprehur shqetësimin lidhur me masën në të cilën Projekti i Bankës është i lidhur fizikisht me investime të tjera që janë propozuar ose janë duke u zbatuar në zonë dhe ndikimin e tyre në saktësinë e projektit. Referimi është bërë me tre investime të mundshme në këtë drejtim: (i) një "park i madh energjetik /industrial "i propozuar"; (ii) një fasilitet i propozuar për ruajtjen e naftës që do të funksionoj mbi baza koncesionale dhe do të jetë i vendosur në një zonë gjysmë të gatshme në jug të TEP në Vlorë; dhe (iii) një ose disa TEP shtesë, të cilat mund të rrisin kapacitetin prodhues në këtë zonë të zgjedhur të Vlorës me kapacitet 300 MW.

50. Grupi i Menaxherëve vëren se propozimi i parë për një park energjetik//industrial është prezantuar gjatë përgatitjes së projektit nga zyrtarët lokal (ky propozim u rrëzua më pas siç është deklaruar shpesh nga Qeveria).<sup>16</sup> Vlerësimi i projektit, megjithatë, tregoi se TEPP është plotësisht i justifikuar bazuar në nevojat për energji elektrike të prodhuar në vend pavarësisht nga vendndodhja e mundshme e njëjtë me një përdorues tjetër të madh. Nëse një park i tillë energjetik ose industrial do të ishte vendosur pranë zonës Vlorë B ose A, do të kërkohej shumë kujdes që ky fasilitet të respektonte ligjin shqiptar. Lidhur me informacionin në dispozicion të Grupit të Menaxherëve, propozimi i parkut energjetik nuk pati sukses as deri në fazën e para fisibilitetit gjatë, të cilit investimet dhe teknologjitë pretendente propozohen. Pa një informacion të tillë kryesor, spekulimi se ajri i ambientit ose uji përreth TEP-së do të ishte devijuar nga kushtet e supozuara do të ishte teknikisht i pamundur gjatë përgatitjes së projektit.

51. Investimi i dytë i propozuar në afërsi të TEP, një terminal naftëmbajtës me koncesion nuk ka lidhje me projektin, i cili do të ketë terminalin e tij të pavarur, tubacionin dhe depozitat naftëmbajtëse. Sipas pikëpamjes së Grupit të Menaxherëve, Banka nuk kishte arsye të kryente vlerësime të projektit për investimet që nuk kanë lidhje me terminalin larg bregut në zonën e përgjithshme.

52. Në lidhje me problemin e tretë, atë të zgjerimit të mundshëm të kapacitetit prodhues në Vlorë me 300 MW, Grupi i Menaxherëve beson se sqarimi i rekordeve është i vlefshëm. Nevoja për rritjen e kapacitetit të prodhimit termal në Shqipëri është pranuar dhe studimi i fisibilitetit është kryer lidhur me shtimin e centraleve të energjisë termale në

---

<sup>16</sup> Shih Aneksin 6, Pergjigjja e Qeverise Shqipëtare për Gjetjet draft të Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus, 'Komente në Paragrafin 25. Sipas Sekretariatit të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë ka propozuar shfuqizimin e Vendimit Nr. 8 Date 19/02/2003 "Për aprovimin e Parkut Industrial dhe Energjetik-Vlorë". Pritet që CTARA do të shfuqizoj vendimin gjatë takimit të radhës.'

Shqipëri. Dokumentacioni i projektit tregon se zona e Vlorës mund të akomodoj fizikisht impiante shtesë prodhimi për një kapacitet të instaluar prej 300 MW. Projekti i Vlerësimit Mjedisor të Korrikut 2003, që u përdor për konsultim publik analizoi cilësinë e ajrit dhe shpërndarjen termale të ujit të ftohtë për kapacitetet 100 dhe 300 MW dhe arriti në përfundimin për të dyja rastet 100 dhe 300 MW, se cilësia e ajrit dhe temperatura e ujit të marrë janë brenda kufijve të pranueshëm nga Banka Botërore dhe KE.<sup>17</sup> Megjithatë, projekti i financuar nga Banka Botërore, EBRD dhe EIB është i kufizuar vetëm në një fasilitet me kapacitet 97 MW dhe Vlerësimi Mjedisor përfundimtar u përqendrua vetëm në këtë kapacitet. Nëse Qeveria vendos të procedoj me njësi shtesë prodhimi (ose në zonën e Vlorës ose në zone tjetër), atëherë një Vlerësim Mjedisor i ri i gjerë duhet të realizohet.

### SAKTËSIA E PËRPUTHJES SË MASAVE MBROJTËSE TË PROJEKTIT

53. Duke kaluar nga problemi i zgjedhjes së zonës dhe investimeve potencialisht të lidhura, Ankuesi ka ngritur probleme lidhur me cilësinë e Vlerësimit Mjedisor të projektit lidhur me saktësinë e karakteristikave të zonës dhe përfundimeve që ndikimet e projektit në një numër zonash do të ishin brenda normave të Bankës dhe të shtetit shqiptar. Perspektiva e Grupit të Menaxherëve në lidhje me këto dy tema, si edhe me reflektimet mbi përputhjen me Kërkesat e procedurave të brendshme janë dhënë në vazhdim

54. Mendimi i Grupit të Menaxherëve është që VM<sup>18</sup> është kryer duke përdorur një përzierje të njohjeve në terren, letërsisë së lidhur me zonën, kontakteve me ekspertët shqiptarë, rishikimit të të dhënave bazë në dispozicion dhe simulimin e ndikimeve duke përdorur modele analitike. Banka Botërore i kërkoj Huamarrësit realizimin e Vlerësimit Mjedisor, në kushtet kur Shqipëria kishte eksperiencë të kufizuar lidhur me drejtimin e punës mbi bazën e standardeve ndërkombëtare kur nisi projekti. Ndaj, VM u përgatit me mbështetjen e ofruar nga USTDA duke kontraktuar një firmë të huaj konsulente të njohur. Ndaj edhe dokumenti i Vlerësimit Mjedisor i realizuar nga ky bashkëpunim plotëson kushtet e Bankës Botërore (si edhe ato të EBRD dhe EIB) për një projekt të kategorisë A nga perspektiva e përmbajtjes dhe perspektiva organizative dhe nëpërmjet një procesi përsëritës të rishikimit të brendshëm e të jashtëm (treguar më lart dhe e zgjeruar në Aneksin 2), Vlerësimi Mjedisor është gjykuar si dokument cilësor në aspektin profesional. Konsultimet dhe shpërndarja e informacionit të VM ka qenë në përputhje me OP 4.01 lidhur me politikën e Bankës për Dhënien e Informacionit. Plotësia (tërësia) e

---

<sup>17</sup> Për shembull, për impaktet e shkarkimeve në ajër, shih f. 63 të Projekt Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor, 17 Korrik, 2003: “Njësia e shkarkimit nga djegia përbëhet nga turbinat, të cilat vihen në punë nga nafta e distiluar, secila e pajisur me një HRSG . Nuk ka ndezje tjetër në HRSG. Pikat e shkarkimit përfshijnë dy oxhaqe; një për çdo HRSG. Një ndërtim i plotë i fasilitetit mund të përfshij njësi shtesë të prodhimit me burime identike shkarkimi. Për qëllime të kësaj analize, një njësi do të modelohet dhe ndikimet nga fasiliteti i plotë do të vlerësohen duke shkallëzuar rezultatet.”

<sup>18</sup> VM nënkupton raportin në dy volume të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (teksti kryesor dhe Shtesa), i cili është shpërndarë sipas Kërkesave të Bankës, e cila përmendet në Përmbledhjen Ekzekutive të përgatitur nga SECBO. “Përmbledhja e Ndikimeve Mjedisore lidhur me Stacionin e Energjisë Termike në Vlorë ” botuar nga EBRD në faqen e saj të internetit është bazuar në materialet nga i njëjti burim.

këtyre konsultimeve është ngritur si problem direkt nga Ankuesi përpara Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus (siç trajtohet në paragrafin 62) dhe mendimi i Grupit të Menaxherëve për këtë problem jepet në këtë pjesë dhe Aneksin 5.

55. Mendimi i Ankuesit se VM ishte “bazuar në keqinterpretim të materialeve të zonës.....[dhe] ishte mashtrues, ilegal dhe i gabuar”, sipas mendimit të Grupit të Menaxherëve nuk mbështetet në asnjë evidencë. Grupi i Menaxherëve vlerëson se VM mbështetet në një informacion, i cili ka nevojë të ripunohet në disa drejtime në kuadrin e progresit të zbatimit. Rishikime të tjera në terren do të kryhen si të jetë e nevojshme dhe kjo përfaqëson një praktikë të mire profesionale. Për të përmendur vetëm një shembull: cilësia e besueshme e ajrit në ambientit nuk ekzistonte në kohën e kryerjes së VM dhe informacioni bazë për modelimin është përafshuar bazuar në një vend gjeografikisht të krahasueshëm dhe në një cilësi mesatare të ajrit të ambientit. Të dhëna të reja në terren janë duke u nxjerrë dhe do të lejojnë të dhënat specifike për zonën që do të përdoren për analizën; rezultatet e analizës së VM sigurojnë një marxhë të konsiderueshëm midis rezultateve të pritshme dhe kufijve të pranueshëm por, nëse është e nevojshme një sintonizim i hollë i zgjedhjeve të teknologjisë dhe funksionimit mund të ndërmerret me qëllim sigurimin e cilësisë së pranueshme të ambientit pasi centrali të vihet në funksionim. Në të njëjtën mënyrë, renditja specifike për tubacionin e naftës dhe ngarkim/shkarkimet e ujit do të zgjidhen bazuar në zgjedhjet e projektit dhe studimet plotësuese në terren. Bazuar në paragrafin e mësipërm, Grupi i Menaxherëve nuk sheh ndonjë fitim të vlerësueshëm në rastin e analizimit të mundësive të tjera për projektin ose të zgjedhjeve të kryera.

56. Një drejtim, për të cilin Grupi i Menaxherëve bie dakord se nuk është trajtuar në mënyrë plotë në dokumentin e VM së është problemi i rishikimit të pasurive potenciale kulturore ndonëse kërkimet fillestare të grupit konsulent për pasurinë kulturore sugjeruan se nuk kishte asete potenciale që mund të gjendeshin në zonën e projektit ndaj vëzhgimi në terren nuk u konsiderua si i nevojshëm. Kur kjo çështje u ngrit përsëri, Grupi i Menaxherëve i konsideroj konsultimet e mëtejshme dhe vizitën në zonë në interes të zgjidhjes së problemit. Një mision supervizioni erdhi në Shqipëri në Korrik të vitit 2006, dhe raporti i këtij misioni është përfshirë në Aneksin 3. Vëzhgimi arriti në përfundimin: “se zona nuk ka ndonjë rëndësi arkeologjike për shkak të vendndodhjeve të qyteteve të lashta të njohura në Gjirin e Vlorës dhe mungesa e ndonjë prove për habitatet njerëzore gjatë gjurmimeve në portin e peshkimit pranë, në fillim të viteve 80 dhe më pas. Rrjedhimisht vëzhgimi i sipërfaqes së zonës së përzgjedhur përpara nisjes së ndërtimit nuk është as i nevojshëm dhe as i justifikueshëm.”

57. Vëmendje e veçantë i është kushtuar shqetësimit të Ankuesit lidhur me ndikimet potenciale në ekosisteme (p.sh.,.... “Peshqve, habitatet natyrore, ekosistemet, kolonitë korale ...”) gjatë rishikimit dhe Grupi i Menaxherëve e konsideron VM dhe masat që duhet të merren gjatë zbatimit si të përshtatshme për këto zona. Zona e projektit është jashtë zonës së mbrojtur të Lagunës së Nartës, e shpallur si e tillë nga Qeveria në vitin 2004 dhe nuk parashikohet të ketë ndonjë ndikim në këtë zonë. Nuk ekzistojnë prova për ekzistencën kolonive korale në bregdetin e zonës së TEP-it. Ndikimet potenciale të projektit, të cilat janë marrë në konsideratë në VM dhe për të cilat Grupi i Menaxherëve beson se ofrojnë siguri të përshtatshme të risqeve të pranueshme përfshijnë: (i)

vendndodhjen e hyrjes së ujit të ftohtë, tubat e shkarkimit dhe tubacionin e furnizimit me naftë, i cili do të zgjidhet në fundin e detit pas konsideratave të kujdesshme; (ii) shpërndarjen e ujit të ftohtë të përgatitur për të arritur limitet e pranueshme të temperaturës përpara kufirit të një zone të përzier duke minimizuar në këtë mënyrë ndikimin mbi peshqit dhe ekologjinë nëndetare; (iii) nuk ka impakte të parashikuara prej ndonjë rënie të kimikateve nga oxhaku i TEP që mund të shkaktoj humbje të biodiversitetit në lagunën e Nartës; dhe (iv) trajtimin e kujdesshëm të ndikimeve potenciale ekologjike dhe masave zbutëse të parashikuara në komponentët e projektit përtej TEP si rehabilitim i aksesit rrugor dhe ndërtim i një linje transmetimi që lidh TEP me rrjetin rajonal. Në fundin e detit përfundon se masat mbrojtëse të habitateve natyrore (OP 4.04) ishin trajtuar në mënyrë të përshtatshme “ si jo të aktivizuara” në ISDS përfundimtare.

58. Hollësi të mëtejshme lidhur me metodat e zbutjes dhe monitorimit janë specifikuar në Vlerësimin Mjedisor dhe do të jenë objekt i një rishikimi të kujdesshëm që do të realizohet nga një firmë e pavarur konsulente mbikëqyrëse që do të kontraktohet. Grupi i Menaxherëve pranon faktin se edhe në kushtet e zbatimit të EMP dhe mbikëqyrjes së punimeve nga një i kontraktuar i pavarur, rreziqet do të mbeten, por ato do të jenë brenda limitit të pranueshëm nga Banka dhe Institucionet Ndërkombëtare Financiare. Metoda që i kontraktuari për funksionimin të japi detaje të mëtejshme lidhur me përputhshmërinë e masave mbrojtëse ( sesa t’ i parashtraj të gjithë hollësitë në VM) është në raport të drejtë me natyrën e funksionimit, derisa një kontratë me EPC do të thotë se kontraktuesi ndërmerr projektin e detajuar, prokurimin dhe ndërtimin e projektit. Grupi i Menaxherëve konsideron, më tej, se projekti garanton supervizion të ngushtë dhe të shpeshtë nga Banka gjatë zbatimit dhe ofrim të vazhdueshëm të mbështetjes së duhur në këtë drejtim.

59. Lidhur me ndikimet mbi potencialin turistik, ky nuk është një problem i mbuluar direkt nga politikat për masat mbrojtëse të Bankës, por vetëm në mënyrë indirekte nëpërmjet problemeve të lidhura si ndikimet potenciale mbi pasuritë dhe habitatet natyrore. Grupi i Menaxherëve vëren se ndërsa turizmi pranë zonës së projektit mund të ketë nivel më të ulët, përfitimi i turizmit nga furnizimi i qëndrueshëm me energji për Vlorën (dhe në përgjithësi për pjesën jugore të vendit) nuk mund të mohohet.

60. Lidhur me masat mbrojtëse ndaj migrimit të detyruar (OP 4.12), Grupi i Menaxherëve vëren se politika është paraqitur në mënyrën e duhur si “ e aktivizuar” në ISDS dhe një kuadër i politikës për marrjen e tokës është përfshirë në PAD dhe është bërë i njohur. Ky Kuadër ishte i nevojshëm për sipërfaqen e vogël të tokës e cila do të nevojitet për kullat e linjave të transmetimit dhe jo për vetë TEP. Marrja e tokës nuk do të sjell shpërngulje të familjeve ose bizneseve, sepse marrja e tokës pronë private ka probabilitet të ulët.

61. Ankuesit ngrenë supozime lidhur me disa mangësi ligjore të tjera. Lidhur me kontestimin e përgjithshëm se procedurat e Bankës kanë shkelur ligjet dhe udhëzimet e KE, Grupi Menaxherëve vëren se Vlerësimi Mjedisor është kryer në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret përkatëse të KE-se. Krahas kësaj, Grupi i Menaxherëve vëren se metoda e vlerësimit e ndjekur nga EBRD dhe EIB, është influencuar mjaft nga Direktivat

e KE bazuar në *acquis mjedisor*. Pretendimet nga Ankuesit se projekti shkel ligjet e Shqipërisë për mjedisin dhe pjesëmarrjen publike nuk kanë bazë ligjore dhe Qeveria ka deklaruar se të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar janë respektuar gjatë aprovimit të projektit dhe gjatë lëshimit të licensave të duhura. Shqipëria sigurisht do të përfitojë nga forcimi i mëtejshëm institucional i Grupi i Menaxherëve mjedisor, por Grupi i Menaxherëve beson se kjo nuk duhet të shkëputet nga fitimet e mëdha që siguron vendi me përgatitjen dhe zbatimin e projektit. Së fundi, pas kontraktimit të EPC, kërkesat shqiptare lidhur me "Aprovimin Mjedisor" të TEP u mor në 16 Shkurt 2007. Licensa mjedisore për TEP u mor në 3 Mars 2007.

62. Kërkesa për Inspektim i referohet një projekt raporti të fundit të nxjerrë nga Komiteti i Respektimit të Konventës Aarhus, përfshirë në aneksin 4.<sup>19</sup> Grupi i Menaxherëve është i mendimit se kuadri i politikës për masat mbrojtëse të Bankës e mbështet Konventën midis të tjerash duke kërkuar një dialog të hershëm dhe kuptimplotë. Perceptimi i Bankës është se procesi i përputhshmërisë nga Komiteti është ende në proces. Grupi i Menaxherëve beson se procesi që çoi deri te projekti i respektoi kërkesat e Konventës. Aneksi 5 paraqet përgjigjen e dhënë ftesës së Komitetit për komente mbi Raportin. Në raport, Banka sqaron ose konfirmon një numër pikash që lidhen me raportin dhe përfshijnë se : (a) projekti është në përputhje me politikën dhe procedurat e Bankës, dhe duke qenë e lidhur edhe me Vlerësimin Mjedisor edhe Kërkesat e dhënies së informacionit dhe konsultimit kanë qenë në përputhje me rregullat relevante.; (b) një analizë e kënaqshme e alternativave u krye për projektin, dhe rezultati i saj u diskutua me aktorët lokal; dhe (c) konsultimi dhe dhënia e informacionit u krye gjatë përgatitjes së projektit në mënyrë të kënaqshme për Bankën dhe partnerët e tjerë. Përgjigjja e Qeverisë dhënë Komitetit të Respektimit të Konventës Aarhus jepet në Aneksin 6.

## V. PËRGJIGJA E GRUPIT TË MENAXHERËVE

63. Ankesat e shoqëruara nga përgjigjet e hollësishme të Grupit të Menaxherëve jepen në Aneksin 1.

64. Grupi i Menaxherëve beson se Banka ka bërë përpjekje të kujdesshme për të zbatuar politikën dhe procedurat e saj dhe për të ndjekur konkretisht misionin e saj në kontekstin e projektit. Sipas pikëpamjes së Grupit të Menaxherëve Banka ka ndjekur udhëzimet, politikën dhe procedurat e zbatueshme lidhur me problemet e ngritura nga Ankuesi. Si përfundim, Grupi i Menaxherëve beson se të drejtat dhe interesat e Ankuesit nuk janë dhe nuk do të jenë, direkt ose indirekt të ndikuara nga dështimi i Bankës për të zbatuar politikën dhe procedurat e saj. .

---

<sup>19</sup> Konventa për aksesin në Informacion , pjesëmarrjen publike në vendimmarrjen dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet Mjedisore (Konventa Aarhus)



ANEKSI 1  
ANKESAT DHE PËRGJIGJET

Nr.	Ankesë/Problem	OP/BP	Përgjigje
Vlerësimi mjedisor, Habitatet Natyrore, Burimet Fizike dhe Natyrore			
1.	<p>Nëse ndërtohet, TEPP në Vlorë ai do të shkatërroj në mënyrë të pariparueshme mjedisin, turizmin, peshqit, habitatet natyrore, ekosistemet, kolonitë korale si edhe vlerën historike dhe arkeologjike të gjithë Gjirit të Vlorës dhe lagunës së Nartës. Me pak fjalë ai shkatërron të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen tonë</p> <p>Bindja jonë është se Banka ka shkëlur politikat lidhur me mjedisin, pjesëmarrjen publike, trashëgiminë kulturore, kërkesat për përputhje të plotë me ligjet shqiptare.</p>	4.01, 4.04, 11.02	<p>Në fazat e para të përgatitjes duke ndjekur një studim të renditjes, Banka Botërore e klasifikoj projektin e TEP në Vlorë si projekt i Kategorisë A për Vlerësimin Mjedisor, duke njohur ndikimin potencial të rëndësishëm mbi mjedisin. Një proces i përsëritur i vrojtimeve në terren, konsultimeve, mbledhjes së të dhënave, analizave dhe modelimit analitik të risqeve kryesore të lidhura me median është kryer. Oponenca të brendshme dhe të jashtme nga stafi i Bankës dhe partnerët e tjerë të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare u kryen dhe zbuluan se risqet mjedisore (duke përfshirë ekosistemet ujore dhe tokësore) mund të zbuten me zgjedhjen e karburanteve të cilësisë së lartë me nivel të ulët ndotës, teknologji të mira kontrolli, dhe një EMP të gjerë e të plotë. Laguna e Nartës nuk do të degradohet nga projekti dhe turizmi në zonën shumë afër mund të bjerë, por përfitimet nga një furnizim më i qëndrueshëm në zonën e Vlorës janë të pamohueshme. Nuk ka prova që mbështesin ekzistencën e kolonive korale në zonat shumë afër TEP. Zona e projektit nuk ka rendësi arkeologjike, po do të zbatohen procedura për identifikimin dhe mbrojtjen e gjetjeve të rastësishme.</p> <p>Projekti ka respektuar politikat e Bankës lidhur me masat mbrojtëse, duke përfshirë politikat për konsultimet dhe dhënien e informacionit. Grupi i Menaxherëve është në dijeni se përputhshmëria në bazë të Konventës Aarhus është aktualisht nën rishikim nga komiteti i zbatueshmërisë së ECE të Kombeve të Bashkuara. Megjithëse Shqipëria nuk është ende anëtare e BE-së, Partnerët Ndërkombëtare Financiare janë kujdesur që projekti të jetë në përputhje me segmentet respektiv të Acquis Mjedisor të KE. Ankuesit nuk kanë dhënë informacion të mjaftueshëm lidhur me mospërputhjen e supozuar me legjislacionin shqiptar dhe Qeveria ka deklaruar se të gjitha kërkesat ligjore janë respektuar si gjatë përgatitjes ashtu dhe gjatë lëshimit të liçensave relevante. Grupi i Menaxherëve vëren se Aprovimi Mjedisor dhe Liçensa janë dhënë në Mars të vitit 2007.</p>
2.	Projekti i Bankës bazohet në keqinterpretimin e materialeve për zonën.	2.20	<p>Një punë e mjaftueshme për vëzhgime në terren dhe për karakterizimin e zonës është kryer gjatë përgatitjes së VM. Kur të dhënat operative mungonin (për shembull të dhënat për cilësinë e ajrit të ambientit) zëvendësues të arsyeshëm janë zgjedhur dhe një program monitorimi në terren është filluar për të mbledhur të dhënat, të cilat do të lejonin të dhënat e veçanta për zonën të përdoren për analizën; rezultatet e analizës së VM sigurojnë një marzh të konsiderueshme midis rezultateve të pritshme dhe kufijve të pranueshëm por, nëse është e nevojshme, një sintonizim i imët (fine-tuning) i zgjedhjeve teknologjike mund të ndërmerret me qëllim sigurimin e cilësisë së pranueshme të ambientit pasi centrali të ketë nisur aktivitetin. Projekti EMP, i cili është pjesë e VM, merr parasysh karakterizimet e mëtejshme të zonës si zgjedhjet që janë bërë për aspekte të projektit si vendndodhja e tubacionit të naftës, hyrja dhe shkarkimi i ujit të ftohtë. Kjo metodë është fleksibël dhe e përshtatshme profesionalisht, si edhe në raport të drejtë me nevojën e rritjes së kapacitetit prodhues në kohën e duhur.</p>
3.	Vlerësimi Mjedisor mbi të cilin bazohet huaja e Bankës është mashtrues, ilegal	4.01	VM është në përputhje me politikat dhe procedurat e Bankës Botërore si edhe të EBRD dhe EIB për mbulimin, saktësinë, dhe

Nr.	Ankesë/Problem	OP/BP	Përgjigje
	dhe i gabuar.		cilësinë teknike. Oponenca e (peer review) brendshme dhe e jashtme, dhënia e informacionit dhe konsultimet kanë qenë të mjaftueshme dhe para kushte të nevojshme për aprovimet e Bordit në vitin 2004.
4.	E gjithë procedura e Bankës që çoj te Projekti ka shkelur ligjet shqiptare për mjedisin, pjesëmarrjen publike, trashëgiminë natyrore dhe Vlerësimin Mjedisor, si edhe ligjet dhe udhëzimet e KE-së.	4.01	Ju lutem shihni paragrafin e fundit tek Pika 1 më lart .
5.	Vlerësimi Mjedisor, ku bazohet huaja e Bankës, i referohet vetëm një centrali termal me 100 MW, ndërsa në vendimin e Qeverisë Nr. 610 datë. 21.9.2004 – për të cilin Banka ose ka patur dijeni ose duhet të ishte në dijeni– është shkruar në mënyrë eksplicite se është rënë dakord të arrihet një kapacitet prej 300 MW në fazat e tjera.	4.01	Nevoja për kapacitete shtesë në prodhimin e energjisë njihet dhe një studim është kryer lidhur me shtimin e numrit të termocentraleve. Dokumentacionet e projektit tregojnë se zona e Vlorës ka hapësira fizike ku mund të ndërtohen termocentrale të tjera për një kapacitet të përgjithshëm të instaluar prodhimi prej 300 MW. Drafti i VM, i përdorur për konsultimet publike, analizoi cilësinë e ajrit dhe shpërndarjen termike të ujit të ftohtë për kapacitetet 100 dhe 300 MW dhe arriti në përfundimin se në të dyja rastet , cilësia e ajrit dhe rritja e temperaturës së ujit marrës janë brenda limiteve të pranueshme nga Banka Botërore dhe KE. Megjithatë, projekti i financuar nga Banka Botërore, EBRD dhe EIB , është i kufizuar në një fasilitet me kapacitet 97 MW. Nëse Qeveria vendos të procedoj me njësi të tjera prodhuese (ose në zonën e Vlorës ose tjetër vend), atëherë një Vlerësim Mjedisor i ri dhe i plotë duhet të kryhet.
6.	Ka shkelje të vetë udhëzimeve të Bankës për termocentralin e ri. (Në udhëzim thuhet: “Kur ekziston mundësia që në një periudhë afatmesme ose afatgjatë centrali do të zgjerohet ose burimet e tjera të ndotjes do të rriten ndjeshëm, analizat duhet të marrin në konsideratë ndikimin e projektit si në momentin aktual edhe pas një zgjerimi të mundshëm të kapacitetit ose të burimeve të ndotjes.”)		Ju lutem shihni përgjigjen në Pikën 5 më lart.
7.	Gjithashtu Qeveria ka aprovuar (Ligjin Nr. 9231 datë. 13.5.04) që 1 kilometër larg TEP të ndërtohen depozitat e naftës në Gjirin e Vlorës me një marrëveshje koncesionale.		Investimi i dytë i propozuar në afërsi të TEP, një terminal naftëmbajtës me koncesion , nuk ka lidhje me projektin, i cili do të ketë terminalin e tij të pavarur, tubacionet dhe depozitat. Sipas pikëpamjes së Grupit të Menaxherëve, vlerësimi për projektin e investimit që nuk ka lidhje me terminalin larg bregut në zonën e përgjithshme nuk ka nevojë të kryhet.
8.	Ne kemi dërguar ankesa te Banka Botërore ne disa raste: Letër drejtuar [Drejtorit të Vendit] dhe [ Menaxherit të vendit], në datë 20 Qershor 2005, <sup>1</sup> letra të ndryshme i janë dërguar [Zëvendës presidentit të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) gjatë gjithë vitit 2006 nga Dr. Anna Kohen, Qytetare nderi e Vlorës	4.01	Banka Botërore mori një letër nga Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës në 30 Qershor, 2005 që ngrinte shqetësime rreth vendimit të ndërtimit të e Termocentralit në Gjirin e Vlorë. Drejtori i Komanduar i asaj kohe për vendin dërgoi në date 1 Gusht një përgjigje që mernte në konsideratë shqetësimet e Aleancës, duke i siguruar se Banka do t'i kushtonte vëmendje atyre, duke rekomanduar një takim me KESH-in për të sqaruar hapësirën e projektit dhe duke siguruar Aleancën se për çdo

<sup>1</sup> [http://guida-shqiptare.net/vloranerrezik/GAZETA\\_percent20VLORA\\_percent20NE\\_percent20RREZIK.pdf](http://guida-shqiptare.net/vloranerrezik/GAZETA_percent20VLORA_percent20NE_percent20RREZIK.pdf) ( ky link nuk funksionon po letra mund të gjendet në <http://www.guida-shqiptare.net/news/art.php?artid=46>).

	<p>dhe Anëtare nderi e Aleancës Civile për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës,<sup>2</sup> takime në Tiranë me [Drejtorin e Vendit], [Menaxherin e Vendit, dhe konsulentin për pasuritë fizike dhe kulturore].<sup>3</sup> Ne nuk kemi marrë përgjigje [ose] ne kemi marrë një përgjigje e cila nuk na kënaq sepse shpjegimet dhe përgjigjet nuk e zgjidhin problemin tonë për arsye të mëposhtme: Përgjigja që i është dhënë z. Sazan Guri injoronte ose keqinterpretonte faktet. Stafi i Bankës që e shkroi atë vetëm ka mohuar. Përgjigjet e dhëna Dr. Anna Kohen' kanë qenë më të kujdesshme, po ende nuk arrijnë të marrin në konsideratë faktet brutale që përmenden në pikat 4, 5 dhe 6]. Takimet e ndryshme me zyrtarë të Bankës ishin gjithashtu plotësisht jo produktive.</p>		<p>investim i ardhshëm që do të ndërmerrej do të shoqërohej me një VM që siguron se ndikimi në mjedis do jetë minimal dhe mund të zbutet. Drejtori dhe Menaxheri i vendit u takuan me përfaqësues të Aleancës në Prill të vitit 2006 dhe diskutuan përsëri këto probleme.</p> <p>Banka Botërore ka marrë gjithashtu gjashtë letra nga Dr Anna Kohen, Presidente e Organizatës së Grave Amerikane- Shqiptare, dhe në atë kohe Presidente e Komitetit Çifut- Shqiptar të Nju Jorkut, gjatë periudhës Janar 2006 –Janar 2007. Zëvendës Presidenti ose Drejtori i Infrastrukturës i është përgjigjur letrave shpejt, në shumicën e rasteve brenda një muaji. Vetëm një përgjigje iu kthye pas dy muajve sepse u pritën përfundimet e gjetjeve të një misioni teknik në Shqipëri i cili u krye për të investiguar në lidhje me disa ankesa specifike të ngritura nga Dr Kohen. Disa prej letrave iu është përgjigjur me ofertë për takim për të diskutuar problemet, në një kohë dhe vend të përshtatshëm për Dr Kohen. Kjo ofertë nuk është marrë në konsideratë.</p> <p>Në secilin rast, problemet reale të ngritura nga Dr Kohen janë trajtuar në mënyrë të plotë nga grupi i Bankës Botërore. Gjatë këtij procesi, grupi i punës ka pasur diskutime me ekspertët në Shqipëri, duke përfshirë ekspertët të Drejtorive të Ministrive, të cilët mbajnë përgjegjësi për Arkeologjinë, Trashëgiminë kulturore dhe Energjinë.</p> <p>Në korrik të vitit 2006, siç është përmendur më lart, Banka kontraktoi një specialist të pasurive kulturore për të kryer një mision teknik në Shqipëri me anëtarët e tjerë të grupit të punës. Grupi u takua me zyrtarë të Qeverisë dhe ekspertë të arkeologjisë dhe pasurisë kulturore jashtë Qeverisë. Grupi takoi gjithashtu përfaqësues të Aleancës Civile në 14 Korrik 2006. Gjetjet e këtij misioni teknik iu bënë të njohura Dr Kohen në një letër të datës 2 Gusht 2006.</p> <p>Në gusht të vitit 2006 Departamenti INT i Bankës Botërore mori gjithashtu një letër nga Aleanca Civile e cila ngrinte pretendime për mashtrim dhe korrupsion, si edhe shqetësime lidhur me vlerësimin mjedisor përgatitur për TEP në Vlorë. INT u përgjigj në Tetor 2006 duke kërkuar më shumë hollësi lidhur me rastet e mashtrimit dhe korrupsionit dhe duke kështilluar Aleancën që shqetësimet lidhur me vlerësimin mjedisor t'ia adresonte Panelit të Inspektimit. Pas kësaj nuk u dorëzua më asnjë informacion.</p> <p>Drejtori Ekzekutiv për Shqipërinë, Greqinë, Italinë, Portugalinë, San Marinon, Maltën dhe Timorin - Leste pas kësaj ka marrë një letër nga Dr Kohenn në date 19 Maj , 2007.</p>
Probleme të tjera			
9.	<p>Ne kemi vërejtur se procedurat për TEPP e Vlorës kanë shkelur plotësisht Nenin 6 të Konventës Aarhus për aksesin në informacion, Pjesëmarrjen Publike dhe Aksesin në Drejtësi sipas përcaktimit të Komitetit të Respektimit të Konventës së Aarhus në Gjetjet Draft dhe Rekomandimet e datës 23 Mars 2007.</p>		<p>Kuadri i politikës së Bankës mbi masat mbrojtëse mbështet Konventën duke kërkuar një dialog të hershëm dhe kuptimplotë. Grupi i projektit vëren se Komiteti i Respektimit të Konventës Aarhus ka nxjerrë gjetjet draft në lidhje me problemin dhe ka ftuar Bankën të jap komentet e saj mbi këto gjetje përpara se ato të finalizohen. Aneksi 5 paraqet përgjigjen ndaj ftesës së Komitetit për komente. Banka ka korrespondencë me Komitetin për këtë çështje. Ajo beson se i gjithë procesi i Projektit ka respektuar Kërkesat e Konventës.</p>
10.	<p>Ne vërejmë se Zyra e Drejtorit Ekzekutiv [...] (EDS21) mund të ketë një konflikt interesi në kryerjen korrekte, të plotë dhe</p>		<p>Grupi i Menaxherëve kundërshton pikën e ngritur në këtë paragraf. Nuk ka asnjë prove që të mbështes këto ankesa, të cilat diskriminojnë stafin vetëm në bazë të kombësisë së tyre.</p>

<sup>2</sup> Gjetend në arkivat e Bankës Botërore ose ju vihet në dispozicion në zyrën tuaj menjëherë pas kërkesës suaj.

<sup>3</sup>Me [Drejtorin e Vendit] dhe [Menaxherin e Vendit ] në 24 Prill 2006 dhe me [konsulentin për burimet Natyrore Kulturore] në 14 Korrik 2006.

<p>të paanshme të investigimit të çështjes. Midis vendeve të tjera, EDS21 përfshin Shqipërinë, Italinë dhe Greqinë. Kompanitë italiane dhe greke mund të kenë interesa të fuqishme ekonomike dhe financiare nga marrja e huasë së Bankës Botërore për TEPP në Vlorë. Për më tepër qytetarët grekë, staf të Bankës Botërore mbajnë përgjegjësi direkt për shkeljet e TEPP si në fazën e planifikimit dhe atë të zbatimit. Për shembull, [...] Drejtoresha e vendit për Shqipërinë[ është greke], [...] siç është].Drejtuuesi i Grupit/Drejtori i Projektit . Së fundi, kontrata për ndërtimin e TEPP në Vlorë, e firmosur në 9 Shkurt, 2007, midis KESH dhe një kompanie të madhe italiane [...].  Ne vetëm mund të shpresojmë që EDS21 realizon detyrat e saj në mënyrën profesionale, etike dhe të përgjegjshme dhe hap rrugën që Paneli i Inspektimit të kryej një investigim gjithëpërfshirës, të paanshëm dhe objektiv pavarësisht nëse qytetare të Italisë dhe/ose Greqisë bëhen objekt i tij.</p>		
---	--	--